



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:013772

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05733124

P. nr. 85/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me bashkëpunëtoren profesionale Hajrije Krasniqi, në lëndën penale kundër të akuzuarve: F.M. nga Malisheva, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, dhe S. M. nga Malisheva, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, të akuzuar nga Prokuroria Themelore Gjakovë - Departamenti i përgjithshëm me aktakuzë PP/II.nr. 1030/2022 të datës 10.07.2023, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 31.01.2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, të dëmtuarve: Sh.Th. dhe S. Th. dhe të akuzuarit F. M., **më 5 shkurt 2024 nxjerr dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F. M.**, nga i ati Sh., e ëma Q., e gjinisë D., i lindur më ..., nga Malisheva i pa martuar, atë i 5 (pesë) fëmijëve, i pa shkolluar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i dënuar më parë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

I.

I akuzuari **F.M.**,

ËSHTË FAJTOR

SEPSE,

Më datën 31.05.2022 rreth orës 21:00/h, në lagjen “M.” në Malishevë, me dashje dhe me mjet të fortë i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit Sh. Th., në atë mënyrë që natën kritike pas një mosmarrëveshje të momentit që kishin mes vete lidhur me fëmijët e të pandehurit pasi të njëjtit duke luajtur me top e kishin goditur veturën e të dëmtuarit, ashtu që pasi i dëmtuarit iu thotë fëmijëve “*mos luani këtu me top se po ma prekni veturën*” nga banesa del i pandehuri F. i cili fillimisht e fyen me fjalë të ndryshme e më pas e godet të dëmtuarin me një hekur në gjoks dhe në dorë si dhe me grusht në fytyrë, me ç’ rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara si në akt ekspertimin mjeko-ligjor të dr. A.G. datë 11.09.2022.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par. 1.4 KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 3,4,7,17,38,39,46,47,48,49,69,70,185 par.2 lidhur me par.1 nën par. 1.4 KPRK-së, dhe neneve 241,242 dhe 364 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin **F.M.** e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntë (9) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej dy (2) vite nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohen i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20,00 €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50,00 €, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari Sh. T. nga M. L. “M.”, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

II.

E akuzuara **S. M.**,

Duke u bazuar në nenin 158 par. 1 të KPP-së, **PJESËRISHT HUDHET** poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm me numër PP/II nr.1030/2022, të datës 10.07.2023.

PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurës **S. M.**, nga Malisheva, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga nenin 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së, **sepse e njëjta ka vdekur.**

E dëmtuara S. Th.nga M. Lagjja "M.", për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzë PP/II.nr. 1030/2022, të datës 10.07.2023, kundër të akuzuarvr: F. M. nga Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së dhe të akuzuarës S. M. nga Malisheva, për shkak të veprës penale nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

PJESA DËNUESE SI NË PIKËN E I-rë TË DISPOZITIVIT.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor më 31.01.2024, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit F. M. iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaron se: me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar në tersi gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë ku edhe formohen të gjitha elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet. Gjykatës i propozoj që të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe ti shqiptoj një dënim meritor konform ligjit duke i vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së.

I dëmtuari Sh.Th.në fjalën përfundimtare deklaron se: kërkoj që të mos dënohet i akuzuari dhe nuk kërkoj kompensim dëmi, nga dita e veprës penale nuk kemi pasur probleme pasi që me të njëjtin jemi komshi me shtëpia. Ky është rasti ynë i parë që kemi pasur probleme.

E dëmtuara S. Th.në fjalën përfundimtare deklaron se: kërkoj që të mos dënohet i akuzuari dhe nuk kërkoj kompensim dëmi, nga dita e veprës penale nuk kemi pasur probleme pasi që me të njëjtin jemi komshi me shtëpia. Ky është rasti ynë i parë që kemi pasur probleme me F..

I pandehuri F. M., deklaron se ndihem i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohem.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor u vërtetua se ai me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: raporti fillestar i incidentit nr. ..., të dt. 01.06.2022; procesverbali i marrjes ne pyetje për te dyshuarin F. M. nr. ..., të dt. 01.06.2022; procesverbali i marrjes ne pyetje për te dyshuarën S.M. nr. ..., të dt. 01.06.2022; procesverbali i marrjes ne pyetje për të dëmtuarin S. Th. nr. 2..., të dt. 01.06.2022; procesverbali i marrjes ne pyetje për të dëmtuarën S. Th. nr. ..., të dt. 01.06.2022; raporti i oficerit B. F., të dt. 31.05.2022; raporti i policit D. S., të dt. 01.06.2022; akt ekspertimi mjeko-ligjor i ekspertit Dr. A. G. i datës 11.09.2022; raporti mjekësor i QKMF M. me nr. rendor ... i datës 01.06.2022; raporti mjekësor i QKMF Malishevë me nr. rendor ... i datës 01.06.2022; fotografitë e të dëmtuarve, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që posaçërisht rrethanë lehtësuese ka marr faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtën e pranoi në mënyrë vullnetare, i premtonte gjykatës se nuk do të përsëris vepër tjetër penale, të dëmtuarit nuk kanë kërkuar që të dënohet i akuzuari dhe nuk kërkojnë kompensim dëmi, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese mori faktin se i akuzuari ka kryer edhe me pare vepra të tjera penale dhe atë: **I.** Në lëndën Penale P.nr. 144/2007, nga neni 161, i cili është i dënuar me dënim me gjobë prej 100 (njëqind) euro, i cili dënim është i plotfuqishëm me datën 23.07.2008; **II.** Në lëndën Penale P.nr. 236/2007, nga neni 153, i cili është i dënuar me dënim me burgim prej 2 (dy) muaj, i cili dënim është i plotfuqishëm me datën 29.04.2011; **III.** Në lëndën Penale P.nr. 233/2008, nga neni 161, i cili është i dënuar me dënim me gjobë prej 300 (treqind) euro, i cili dënim është i plotfuqishëm me datën 20.09.2008; **IV.** Në lëndën Penale P.nr. 305/2013, nga neni 260, i cili është i dënuar me dënim me kusht 3 (tre) muaj burgim brenda një viti, i cili dënim është i plotfuqishëm me datën 12.05.2016; **V.** Në lëndën Penale P.nr. 388/2013, nga neni 188, i cili është i dënuar me dënim me kusht 3 (tre) muaj burgim brenda një viti, i cili dënim është i plotfuqishëm me datën 03.03.2016; **VI.** Në lëndën Penale P.nr. 109/2015, nga neni 188, i cili është i dënuar me dënim me gjobë prej 200 (dyqind) euro, i cili dënim është i plotfuqishëm me datën 01.06.2015; **VII.** Në lëndën Penale P.nr. 217/2015, nga neni 188, i cili është i dënuar me dënim me gjobë prej 200 (dyqind) euro, i cili dënim është i plotfuqishëm me datën 30.09.2015; **VIII.** Në lëndën Penale P.nr. 99/2001, nga neni 39, i cili është i dënuar me dënim me kusht 5 (pesë) muaj burgim brenda një viti, i cili dënim është i plotfuqishëm me datën 07.05.2002; **IX.** Në lëndën Penale P.nr. 116/2004, nga neni 39, i cili është i

dënuar me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, i cili dënim është i plotfuqishëm me datën 04.01.2007; X. Në lëndën Penale P.nr. 292/2004, nga neni 153, i cili është i dënuar me dënim me burgim prej 3 (tre) muaj, i cili dënim është i plotfuqishëm me datën 13.10.2008, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, si vendin, kohën dhe motivin e kryerjes së veprës penale, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, të akuzuarin e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 2 (dy) vite nuk kryen vepër tjetër penale me bindjen se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 452 par. 4 të KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

PJESA REFUZUESE SI NË PIKËN E II-të TË DISPOZITIVIT.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka konstatuar se në këtë çështje penale e pandehura S. M. nga Malisheva, për shkak se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, ka vdekur më dt. 26.04.2023. Gjykata sipas detyrës zyrtare ka **hedhe pjesërisht** aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm me numër PP/II.nr.1030/2022, të datës 10.07.2023, dhe ka **pushuar** procedurën penale ndaj të pandehurës S. M. nga Malisheva, për shkak se kishte për të kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

S. M., e lindur me dt. ..., me nr. personal ..., ka vdekur me dt. 26.04.2023, sipas Certifikatës se Vdekjes nr. serik V ... nr. referencës ..., Zyra e Gjendjes Civile M., B., dt. e lëshimit 10.05.2023, nga Zyrtari i Gjendjes Civile I. Z..

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr bazuar në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 362 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.85/2023, më 5 shkurt 2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në ekzemplar të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.